



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.310/17

**GJYKATA THEMELORE NËGJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtarja Florije Qerimi, në kontestin e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, Rr. „ Lidhja e Pejës” , Magj.Prishtinë –Fushë Kosovë, pa.nr. të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Faik Sylejmani, jurist i diplomuar nga Prishtina, kundër të paditurit R. M., nga fsh. Gumnishtë, K.Gjilanit, për rimbursim dëmi, pas shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 14.01.2019, përpiloi aktgjykimin më datë 25.03.2019 këtë:

### AKTGJYKIM

**I. APROVOHET** - në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë.

**II. DETYROHET** i padituri R. M., nga fsh. Gumnishtë, K. Gjilanit, që paditëses t’ia rimbusojë shumën prej 1250.00 € ( një mijë e dyqindë e pesëdhjetë euro), në emër të dëmit material, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e dhënies së këtij aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**III. DETYROHET** i padituri R. M., që paditëses tia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 15 €, për pagesën e taksës gjyqësore për këtë padi, brenda afatit 15 ditor, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Paditësja, me datë 19.04.2017, ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate, kundër të paditurit R. M., nga fsh. Gumnishtë, me objekt kontesti rimbursimit e dëmit shumën prej 440.00 €, për shkak të aksidentit të trafikut që kishte ndodhur në Gjilan, më datën 10.03.2013, me automjetin Mercedes 124, me targa të regjistrimit 05-397-AK, pasi që vetura që po e voziste i padituri nuk kishte qenë e siguruar, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, paditësja ka qenë e obliguar në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, që tia kompenzojë të dëmtuarve Familjes R., dëmin material dhe jomaterial të pësuar si rezultat i aksidentit, dhe me këtë padi ka kërkuar që të detyrohet i padituri që t’ia kompensojë paditëses në emër të rimbursimit të dëmit me kamatë siç paguajnë bankat për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të veçantë, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj, njëkohësisht duke e paralajmëruar të paditurën, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë-mosbindjes, nëse plotësohen kushtet ligjore.

I padituri më datë 16.08.2017, ka pranuar Aktvendimin për përgjegje në padi por i njejt nuk ka ushtruar përgjegje në padi me të cilin do ta kundërshtonte kërkesëpadinë e paditësit, po ashtu edhe në seancën pregaditor të datës 11.12.2018, ka pranuar ftesën më datë 30.11.2018, dhe ate të shqyrtimit kryesor të datës 14.01.2019, bashkë me ftesë ka pranuar edhe procesëverbalin e datës 11.12.2018 , i cili është fituar në mënyrë të rregullt edhe përkundër që e ka pranuar ftesën personalisht më datë 19.12.2018, në mënyrë të rregullt, nuk ka prezentuar në shqyrtimet gjyqësore dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Përfaqësuesi i paditëses Faik Sylejmani, jur.i dip.nga Prishtina, i pranishëm në seancë i ka propozuar gjykatës që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në mungesë të paditurit pasi që i njejt e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesi i paditëses në shqyrtimin gjyqësor ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sa i përket shumës së kërkuar me kërkesëpadi pasi që në shkresat e lëndës gjenden disa vlera të ndryshme të kompenzimeve për palët e dëmtuara dhe ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses tia paguaj shumën prej 1250 € ( një mijë e dyqindë e pesëdhjetë euro), me kamatë ligjore prej 8% , si dhe shpenzimet e procedurës në emër të taksës për padi, sa i përket precizimit të kërkesëpadisë nga ana e paditëses, gjykata e ka njoftuar të paditurin me procesëverbalin e datës 14.01.2019 më datën 04.03.2019 dhe i njejt nuk ka dhënë përgjegje në gjykatë.

### ***Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar***

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka administruar këto prova:

Pasqyra e transaksionit në bankën ekonomike e datës 16.07.2013, Urdhërtransferi i datës 10.07.2013 me nr. 1392/13, ujdia jashtëgjyqësore e datës 17.06.2013 me nr.734/13, Urdhërtransferi për Lorina Ramadani, i datës 10.07.2013, Ujdia jashtëgjyqësore për Lorina Ramadani, e datës 03.07.2013 me nr. 734/13, Raporti i policisë i datës 10.03.2013, me nr.2013-CR-055, Pasqyra e transaksioneve ne Bankën Ekonomike e datës 16.07.2013, Urdhertansferi për E. R., me nr. 7341/13 e datës 08.07.2013, Ujdia jashtëgjyqësore në emër të E. R., me nr.7341/13 e datës 08.07.2013, Vendimi i Komisionit i datës 10.06.2013, Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim në emër të Sh. R., i datës 16.04.2013, Vendimi i komisionit i datës 10.06.2013, vendimi i komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve i datës 10.06.2013, Formulari për kompenzimin e dëmit jo material në shumë prej 430 euro i dtaës 10.06.2013, Raporti për vlerësimin e ekspertve mjekësor në emër të E. R. datës 15.05.2013, Formulari i kompenzimit të dëmit jo material në vlerë prej 380 euro i datës 16.06.2013, Raporti i vlerësimit të ekspertve mjekësor në emer të të L. R., i datës 15.05.2013, Formulari për kompenzimin e dëmit jo material në emër të Sh. R., në vlerë prej 440 euro, Raporti i vlerësimit të ekspertve mjeksor ne emër të Sh. R., i datës 15.05.2013, Informata e Komisionit të vlerësimit të dëmeve e datës 29.04/2013, Fotot e bashkëngjitura në shkresat e lëndës , Vendimi i komisionit të shkallës së parë nr. 1017/2013, i datës 12.04.2013, Raporti i Spitalit Regjional i Gjilanit- Emergjenca, i datës 10.03.2013, në emër të Sh. R., Raporti i Spitalit Regjional – Emergjenca, i datës 10.03.2013, ne emër të L. R. dhe Rappoti i Spitalit Regjional- Emergjenca, i datës 10.03.2013, në emër të E. R..

## **Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës.**

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar**.

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë e ka vërtetuar faktin se më datë 10.03.2013, rrethë orës 13: 45 min., në magjistralen Gjilan –Prishtinë, afër motel „ Kosova” , në fshatin Bresalcë, K. Gjilanit, ka ndodhur aksident trafiku ku kanë qenë të përfshira dy vetura e të cilat i ishin duke lëvizur në drejtim të njëjtë, vozitësi i automjetit MERCEDES 124, me targa të regjistrimit 05-397- AK, të cilën e drejtonte R. M., pa mbulesë siguroese, duke mos ia përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës dhe duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme gjatë vozitjes, në mes mjetit të tij dhe mjetit para tij, e godet automjetin e udhëtarëve AUDI , me targa të regjistrimit 01-596-AS, të cilën e drejtonte Sh. R., nga Prishtina, e ku pos dëmeve materiale lëndime trupore marrin Familja R. (Sh. , E. dhe L. R. ) nga Prishtina, dhe se paditësja në emër të dëmit material dhe jo material i ka kompenzuar të dëmtuarës shumën prej 1250 €.

-Nga pasqyra e transaksionit në Bankën Ekonomike e datës 16.07.2013, gjykata vërtetoi faktin se në llogarin me nr. 1110-2834-9700-0127, në Pro Credit Bank, janë transferuar 440 €, në emër të Sh. R., dhe në emër të Sh. R., për L. R., shuma në vlerë prej 380 €, ndërsa në emër të E. R. janë transferuar në llogarinë 1300-0030-0579-5251 në BPB, shuma në vlerë prej 430 €.

-Nga Ujdia jashtëgjyqësore e datës 17.06.2013 me nr.734/13, gjykata vërtetoi faktin se është arritur ujdia mes paditëses dhe të dëmtuarës Familja R., në emër të Sh. R., për dëmin material dhe jo material të kompenzohet në shumën prej 440.00 €, në Bankën Ekonomike, në nr. të llogarisë 1110-2834-9700-0127.

-Nga Ujdia jashtëgjyqësore për L. R., e datës 03.07.2013 me nr. 734/13, gjykata vërtetoi faktin se është arritur Ujdia mes paditëses dhe të dëmtuarës Familja R., që në emër të dëmit material dhe jo material për L. R., të kompenzohet në shumën prej 380.00 €, në Bankën Ekonomike, me nr. të llogarisë 1110-2834-9700-0127, ( në konto të Sh. R.).

-Nga Raporti i policisë i datës 10.03.2013, me nr.2013-CR-055, gjykata vërtetoi faktin se në magjistralen Gjilan –Prishtinë, afër motel „ Kosova” , në fshatin Bresalcë, K. Gjilanit, ka ndodhur aksident trafiku ku kanë qenë të përfshira dy vetura e të cilat i ishin duke lëvizur në drejtim të njëjtë, vozitësi i automjetit MERCEDES 124, me targa të regjistrimit 05-397- AK, të cilën e drejtonte R. M., duke mos ia përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës dhe duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme gjatë vozitjes, në mes mjetit të tij dhe mjetit para tij, me pjesën e përparme të veturës së tij e godet në pjesën e pasme automjetin e udhëtarëve AUDI , me targa të regjistrimit 01-596-AS, të cilën e drejtonte Sh. R., nga Prishtina, e ku pos dëmeve materiale lëndime trupore marrin Familja R. (Sh. , E. dhe L. R. ) nga Prishtina.

-Nga Ujdia jashtëgjyqësore në emër të E. R., me nr.7341/13 e datës 08.07.2013, gjykata vërtetoi faktin se është arritur Ujdia mes paditëses dhe të dëmtuarës Familja R., nga Prishtina, që në emër të dëmit material dhe jo material për E. R., të kompenzohet në shumën prej 430.00 €, në Bankën për Biznes, me nr. të llogarisë 1300-0030-0579-5251.

## **Vendimi i gjykatës**

Gjykata bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lart, përkatësisht duke u bazuar se si shkatar i vetëm në aksidentin e dt.10.03.2013 ka qenë tani i padituri, i njëjti përkatësisht vetura e tij nuk ka pasur sigurim në momentin e aksidentit, kurse paditësja për aksidentin e dt.10.03.2013, të dëmtuarit Familja R., nga Prishtina, ia ka kompensuar shumën prej 1250.00 €, duke u bazuar në nenin 18 pika 1 e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësish, shprehimisht ka paraparë se “ **Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronar i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësish, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja**”, andaj në rastin konkret u vëretua se i dëmtuari ka paraqitë kërkesë pranë paditëses dhe kjo e fundit ka paguar dëmin material dhe jo material të dëmtuarit, kurse neni 18 pika 4 e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësish ka paraparë se “ **Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat**”, andaj në rastin konkret është vërtetuar se e paditura është përgjegjës për aksidentin e dt.1.03.2013, e rrjedhimisht e njëjta duhet edhe të ia paguaj dëmin e paguar nga ana e paditëses të dëmtuarit Familja R., dhe për këto arsye, gjykata vendosi në pikën I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe ka detyruar të paditurën që paditësit tja paguaj shpenzimet gjyqësore për pagesën e taksës gjyqësore për padi në lartësi prej 40 €, duke u bazuar në nenin 452 pika 1 të LPK.

Nga të lartcekurat bazuar në nenin 18 pika 1 dhe 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësish, dhe nenit 143 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr.310/17 i datës 25.03.2019**

**Gjyqtarja**  
Florije QERIMI

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

